

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА  
БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



**Наставна програма**  
**АЛБАНСКИ ЈАЗИК (ЈАЗИК НА ЗАЕДНИЦАТА)**  
за VII одделение

**Programi mësimor**  
**GJUHË SHQIPE (GJUHË E BASHKËSIVE)**  
për klasën VII

Скопје, Shkup, 2024

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

<b>Lënda mësimore</b>	Gjuhë shqipe (gjuhë e bashkësive)
<b>Lloji/kategoria e lëndës mësimore</b>	Lëndë me zgjedhje
<b>Klasa</b>	VII (e shtatë)
<b>Temat/fushat programore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përditshmëria ime në mjedisin ku mësoj, ku jetoj dhe ku shoqërohem</li> <li>• Në rrethinën e afërt</li> <li>• Komunikimet, lidhjet dhe njohja e dallimeve</li> </ul>
<b>Numri i orëve</b>	2 orë në javë / 72 orë në vit
<b>Pajisjet dhe mjetet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, dërrasë e zezë, teknologji kompjuterike, printer.</li> <li>• Mjetet dhe burimet mësimore: foto, fotografi, postera, postera nga libra, diagrame dhe ekspozita të materialit mësimor, tabela që përcjellin materialin mësimor sipas fushave; fjalorë, fjalorë drejtshkrimi, leksikon, enciklopedi, libra, programe edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale;</li> <li>• Biblioteka me libra në klasë, biblioteka e shkollës.</li> </ul>
<b>Normativi për kuadrin mësimor</b>	<p>Mësimdhënjen e lëndë së gjuhës shqipe (gjuhë e bashkësive) në klasën e VII të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi i cili ka kryer drejtimin arsimor të programeve studimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi*</li> </ul> <p><i>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike.</i></p>

## NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënimit që përmenden në Programin mësimor shpesh në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Përdorimi i gjuhëve të tjera – Gjuhë shqipe (gjuhë e bashkësive)**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
II-A.1	të kuptojë fjalitë dhe frazat që përdoren shpesh dhe që kanë të bëjnë me fusha të afërta me rëndësi personale (të tilla, si informacione personale dhe familjare, nevoja dhe interesa të ndryshme);
II-A.2	të nxjerrë porosinë kryesore nga mesazhet e thjeshta e të qarta, nga njoftimet, nga udhëzimet nga lutjet etj.
II-A.3	të lexojë dhe të kuptojë tekste të thjeshta të llojeve të ndryshme, për tema të njohura dhe më pak të njohura, të përshtatshme për moshën;
II-A.4	të gjejë informacione konkrete në tekste reale të ndryshme (p.sh. në reklama, në plane, në udhëzime, në broshura, në lista ushqimesh, në orare udhëtues etj.) dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta, për të menaxhuar situatat e përditshme;
II-A.5	të komunikojë në situata të përditshme konkrete kur kërkohet një shkëmbim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë informacioni për tema të njohura;
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe saktë të gjithë tingujt dhe grupet e tingujve, duke respektuar rregullat e theksit dhe intonacionit, ndërkohë që parregullsitë e mundshme të mos e pengojnë komunikimin;
II-A.7	të përdorë shprehje të zakonshme dhe fjali që përdoren gjatë përvojës së drejtpërdrejtë dhe/ose u referohen temave dhe situatave me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.8	të shkruajë fjalë dhe shprehje me saktësi relative, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit;
II-A.9	të respektojë rregullat themelore të gramatikës në të shprehurit me shkrim dhe me gojë;
II-A.10	të shprehë dhe të argumentojë ndjenjat dhe mendimet në lidhje me çështjet me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.11	të përdorë varg deklaratash dhe fjalish për të shkruar një mesazh, një letër, një shënim, një kartolinë dhe të përshkruajë me fjalë të thjeshta gjërat me interes të drejtpërdrejtë;

<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
II-B.1	të mësuarit e një gjuhe tjetër lehtëson mësimin e shumë gjuhëve dhe mundësinë e komunikimit me anëtarë të grupeve të ndryshme kulturore/gjuhësore;
II-B.2	njohja e më shumë gjuhëve lehtëson qasjen në burime që janë të dobishme për përvetësimin e lëndëve/përmbajtjeve të tjera mësimore;
II-B.3	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet interesi dhe respekti për gjuhët dhe kulturat e ndryshme;
II-B.4	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet respekti për kulturat e tjera dhe përmirësohen kompetencat ndërkulturore.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të fushave të Standardeve nacionale, siç janë: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura.**

#### IV. Njohuri digjitale

<i>Nxënësi/nxënësjja di dhe mund:</i>	
IV-A.1	të hulumtojë dhe të krahasojë mundësitë e pajisjeve dixhitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë apo për një situatë konkrete;
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, të zgjedhë dhe instalojë programe që i nevojiten, të përdorë programe mbrojtëse dhe të zgjidhë probleme rutinë në funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve të ndryshme digjitale;
IV-A.3	të përdorin mënyra të ndryshme për të organizuar, për të ruajtur dhe për të ndarë në mënyrë të sigurt përmbajtjet në pajisje dhe rrjete të ndryshme në hapësirën digjitale;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët të analizojë një problem, të zhvillojë ide dhe plane për hulumtimin dhe për zgjidhjen e tij dhe të planifikojë kur dhe për çfarë të përdoret TIK-u;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale dhe të vlerësojë lidhjen e tyre me nevojën konkrete dhe besueshmërinë e burimit;
IV-A.6	të zgjedhë dhe të përdorë mjete të ndryshme për përpunimin e të dhënave, të analizojë të dhënat dhe t'i paraqesë ato në mënyra të ndryshme duke respektuar rregullat e përdorimit;
IV-A.7	të zgjedhë dhe të përdorë mjetet e duhura të TIK-ut për komunikim, të ndajë në mënyrë të sigurt informacionin, të kontaktojë dhe të bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, në aktivitete sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët, respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën digjitale multikulturore;
IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
IV-A.11	të planifikojë dhe zhvillojë pjesë udhëzimesh të qarta për kryerjen e një detyre specifike dhe t'i paraqesë ato si një algoritëm programimi;
IV-A.12	të hulumtojë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, duke kombinuar paraqitje statike dhe dinamike, zë, tekst dhe imazhe për të modifikuar ose krijuar produkte të thjeshta multimediale me një qëllim të caktuar dhe për një audiencë specifike;
IV-A.13	të përcaktojë kriteret e cilësisë për produktet dhe zgjidhjet digjitale duke përfshirë inovacionin dhe dobinë prej tij.
<i>Nxënësi/nxënësjja kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;

IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe jo i duhur i TIK-ut ka kufizime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose për shoqërinë;
IV-B.3	potencialet e TIK-ut do të rriten prandaj duhet të ndiqen dhe përdoren duke pasur qasje kritike ndaj besueshmërisë, konfidencialitetit dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, privatësisë dhe sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes dhe dhuna kibernetike dhe të respektohen rregullat dhe normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacioni i disponueshëm në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;
IV-B.6	duhet të respektohen të drejtat e pronësisë intelektuale të produkteve të disponueshme në rrjetet digjitale;
IV-B.7	pozita jo e duhur e trupit dhe përdorimi i pamasë i teknologjive digjitale mund të ndikojë negativisht në shëndetin, jetën personale dhe sociale dhe ruajtja jopërkatese e hedhurinave digjitale ndikon në mënyrë të pavolitshme në mjedisin jetësor.

## V. Zhvillim personal dhe social

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
V-A.1	të dallojë mënyrën e shëndetshme të jetesës nga ajo e rrezikshmja në të gjitha sferat e jetës (duke përfshirë zakonet e të ngrënit, aktivitetet sportive dhe rekreative dhe sjelljen seksuale);
V-A.2	të zgjedhë dhe të praktikojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tij mendore dhe fizike;
V-A.3	të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet i cili ndërtohet mbi bazën e përkatesisë ndaj identitetit të ndryshëm shoqëror (p.sh. gjinia, identiteti etnik dhe kombëtar) dhe rolet e ndryshme që ka në jetë (p.sh. nxënësi, djali/vajza);
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij / asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet e vetvetja dhe të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatese për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimit e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj, në mënyrë efikase dhe efektive të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të të tjerëve për veten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.11	të veprojë në mënyrë të pavarur, me vetëdije të plotë se kujt, kur dhe si të kërkohet ndihmë.
V-A.12	të përballojë me sukses presionet sociale;

V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.16	të njohë problemet në marrëdhëniet me të tjerët dhe t'i qaset në mënyrë konstruktive zgjidhjes së konflikteve, duke respektuar të drejtat, nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (kthyes) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë, të bëjë pyetje përkatëse, për të zbuluar probleme, për të analizuar dhe vlerësuar informacionin dhe propozimet dhe për të kontrolluar supozimet;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.20	të analizojë në mënyrë kritike informacionin dhe dëshmitë sipas kriterëve përkatëse;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënëit.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.1	kujdesi për trupin dhe praktikimi i rregullt i aktiviteteve fizike është kusht i rëndësishëm për të siguruar shëndet të mirë fizik dhe mendor;
V-B.2	njohja e identitetit personal kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.5	zgjidhja e problemeve dhe konflikteve, varet nga mënyra se si i qaset zgjidhjes së problemeve dhe zgjidhjes së konflikteve;
V-B.6	suksesi në jetë, në një masë të madhe, varet nga qëllimet që ai i vendos vetes , ndërsa efikasiteti dhe efektiviteti në arritjen e qëllimeve të vendosura në masë të madhe varet nga mënyra se si ai i planifikon aktivitetet dhe organizon kohën e tij;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese (kthyes) dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.
V-B.10	të mësuarit është një proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.

## VI. Shoqëri dhe kulturë demokratike

<i>Nxënësi/nxënësjja di dhe mund:</i>	
VI-A.1	të shpjegojë se si faktorët socialë ndikojnë në personalitetin e njeriut dhe në mjedisin jetësor dhe t'i marrin ato parasysh gjatë formimit të opinionëve dhe marrjes së vendimeve;
VI-A.2	të analizojë sjelljen e vet me qëllim të përmirësimit, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;
VI-A.3	të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tij, të dëgjojë dhe të analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me respekt edhe kur nuk është dakord me to;
VI-A.4	të reflektojë në mënyrë kritike për vlerat dhe sjelljet e ndryshme personale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme (veçanërisht në situata të ndjeshme etike), të respektojë normat dhe vlerat e pranuar nga shoqëria, por edhe t'i sfidojë ato kur mendon se është e nevojshme;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e pambrojtura (vulnerabël), në shoqëri të marrë pjesë në to dhe të mbështesë veprime humanitare dhe vullnetare;
	të identifikojë dhe t'i rishqyrtojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që manifestohen në mjedisin e tij/saj;
I-A.19	të shpjegojë rëndësinë e proceseve demokratike në shoqëri dhe të zbatojë parimet e pjesëmarrjes demokratike në kuadër të shkollës.
<i>Nxënësi/nxënësjja kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.1	nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, orientimi seksual, etj.)
VI-B.2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;
VI-B.3	të drejtat e njeriut janë universale dhe kufijtë e të drejtave të çdo personi janë të drejtat dhe liritë e të tjerëve;
VI-B.4	respektimi pa dallim i të drejtave dhe lirive të njeriut është thelbësor për mirëqenien e individëve dhe shoqërisë në tërësi;
VI-B.5	barazia, e drejta dhe kohezioni social janë thelbësore për funksionimin e suksesshëm të komunitetit;
VI-B.6	angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë të rëndësishëm për arritjen e interesit të përbashkët publik;
VI-B.7	çdo qytetar është i detyruar të sillet me përgjegjësi ndaj bashkëqytetarëve të tij, ndaj komunitetit dhe shoqërisë në tërësi, duke pasur parasysh vazhdimisht pasojat e veprimeve të tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit;

VI-B.12	vendi ynë është një shoqëri multikulturore/multietnike në të cilën jetojnë anëtarë të kulturave/etnive të ndryshme dhe secili qytetar të saj është përgjegjës për të kontribuar në shkëmbimin ndërkulturor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në interes të të jetuarit së bashku në një shoqëri të integruar dhe etnikisht kohezive.
---------	---

### VIII. Të shprehurit artistik dhe kulturë

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike;
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e afërt dhe atë të gjerë dhe të analizojë ndërlidhjen dhe varësinë reciproke të tyre.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VIII-B.4	diversiteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme;
VIII-B.5	dallimet ndërmjet kulturave duhet të shihen si mundësi për të mësuar dhe si sfidë për mirëkuptim dhe përparim të ndërsjellë;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit të kulturës së vet nga të tjerët.



## REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: **Përditshmëria ime në mjedisin ku mësoj, ku jetoj dhe ku shoqërohem**

**Gjithsej: 25 orë**

### Rezultatet e të nxënit:

*Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë:*

1. të shqiptojë drejt tingujt e gjuhës standarde shqipe, duke bërë dallimin mes shqiptimit të tingujve në shqip dhe në gjuhën amtare;
2. që me dëgjim t'i njohë fjalët e theksuara saktë dhe të theksojë saktë fjalët e mësuara sipas rregullave për theksim në gjuhën standarde shqipe;
3. të përdorë leksik/fjalë me të cilat prezanton saktë veten dhe leksik/fjalë dhe shprehje të përshtatshme kur komunikon me persona të tjerë;
4. t'i emërtojë, t'i tregojë karakteristikat (tiparet) e veta që flasin për veçantinë e tij/saj, sjelljen me familjen dhe mjedisin, duke përdorur trajtat e emrave, të mbiemrave, të përemrave dhe trajtat foljore përkatëse;
5. të përdorë fjalë nga fjalori i gjuhës shqipe dhe të zbatojë kuptimin e saktë të tyre në një kontekst/situatë komunikimi;
6. të lexojë tekste në gjuhën shqipe duke respektuar rregullat e shqiptimit dhe të lidhjes së e fjalëve;
7. t'u përgjigjet pyetjeve, të nxjerrë fjalë e shprehje të panjohura, të njohë përgjigjen e saktë dhe të ndërtojë fjali të shkurtra në lidhje me tekstet që i dëgjon dhe i lexon.

### Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)

#### a) Modelet e komunikimit

- **Kush jam unë**  
*Unë jam një nxënës, një nxënëse, një sportiste, një sportist, një koriste, një korist, një matematikan, një matematikane, një kopshtar, një kopshtare, një valltare, një valltare...*
- **Karakteristikat (tiparet) e mia**  
(theksimi i tipareve të mira që na dallojnë nga të tjerët, për shembull: *i shoqërueshëm/ e shoqërueshme, i besueshëm/ebesueshme, i/e sinqertë, i kujdesshëm/e kujdesshme ...*)

### Standardet për vlerësim:

- Shqipton saktë fjalët e reja dhe i përdor në kontekste të përshtatshme gjuhësore.
- Prezanton saktë veten duke përdorur modele të shkurtra gjuhësore, shprehje të sakta gjuhësore dhe i tregon arritjet dhe sukseset e veta pozitive.
- Përdor shprehje të përshtatshme për t'i treguar personat që i admiron dhe shembuj që i ndjek dhe i adhuron tek ata.
- Numëron saktë karakteristikat (tiparet) e një personi tjetër (të famshëm).
- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve që kanë të bëjnë me sjelljen e vet/personale, sjelljen e/ndaj prindërve/shokëve/mësimdhënësve.

- **Unë jam unik/e në ...**

(p.sh. *Kam fituar një çmim për lexim të mirë tri herë.*) "Unë jam ... (emri i tij/saj) dhe jam unik/e në ...".

- **Modelet dhe personat që i admiroj (muzikantë, sportistë, shkrimtarë dhe shkencëtarë)**

*Unë e admiroj këtë person (p.sh. shkencëtar, shkrimtar, artist, personazh nga një vepër letrare, hero nga një film apo serial ...) sepse ...*

- **Unë në familjen time, unë dhe/me të tjerët**

*Çfarë bëj në shtëpi? Si marr pjesë në jetën e përbashkët? Me kë jam më i/e afërt? (prindërit/kujdestarët; shokët; shkolla; muzika; sportet dhe gjëra të tjera të rëndësishme) Për momentin i ndiej më të afërt shokët e mi. Për momentin ai e ndien më të afërt sportin/futbollin.*

- **Unë në shkollë**

(orari i orëve, lëndët, lëndët e preferuara, shpjegimi se pse lëndët ose temat që i interesojnë janë të preferuara për të).

Detyrimet e shkollës (detyrat e shtëpisë, projektet, kërkimet, eksperimentet, kujdestaritë)

*Kam orar të ri të orëve mësimore.*

*Orari im këtë vit është:...*

*Cili është orari yt i orëve mësimore?*

*Cilat lëndë te reja mësimore i ke këtë vit?*

*A kemi detyra shtëpie në gjuhën shqipe?*

*Po, kemi, të shkruajmë pesë fjali.*

- Tregon mënyra të ndryshme për pjesëmarrje aktive në jetën familjare.
- Dëgjon, kupton dhe u përgjigjet pyetjeve/informacioneve që lidhen me jetën shkollore.
- Paraqet orarin e vet të orëve mësimore sipas lëndëve dhe sipas numrit të orëve.
- Numëron lëndët e preferuara dhe jep shpjegime të shkurtra për to.
- Harton thënie për përgjegjësitë e tij/saj shkollore.
- Parashtron pyetje lidhur me detyrimet e shkollës.
- U përgjigjet pyetjeve në lidhje me shkollën dhe përgjegjësitë e saj.
- Inicon dhe merr pjesë në dialogë, në të cilët shprehet për përgjegjësitë që ka në shkollë, për oraret dhe për lëndët.
- Harton thënie me fjalorin e duhur duke përdorur trajtat e duhura të foljeve të vetës për kohën e tashme dhe për të kryerën e thjeshtë.
- Përdor thënie duke përdorur në mënyrën e duhur fjalët pyetëse në fjalitë pyetëse (*a, nëse, çfarë, kush, çka*).
- Përdor fjali duke përdorur saktë ndajfoljet të kohës, numërorët dhe përemrat dëftorë e pronorë.
- Përdor thënie në të cilat i tregon aktivitetet e tij të përditshme.
- Arsyeton si duhet të duket shkolla e tij sipas vizatimit të bërë ose sipas animacionit kompjuterik.
- Tregon arsyet pse dëshiron/mund të bëjë gjëra të caktuara ose nuk dëshiron/nuk mund t'i bëjë ato.
- Prezanton planet e tij/saj për iniciativat e nxënësve
- Kupton dhe komenton shkurt pyetjen e parashtruar për temën e dhënë.
- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve që lidhen me ngritjen e cilësisë së jetës në shkollë dhe në shtëpi.
- Nxit ose përfshihet në një dialog ose bisedë të shkurtër lidhur me secilën nga njësitë tematiko-komunikuese.

*Sot për detyrë shtëpie kemi të bëjmë kërkim për...  
Dje bëme një eksperiment biologjik.*

- **Plani im ditor për mësim dhe argëtim**

*Unë zgjohem në orën shtatë çdo mëngjes. Vishem dhe shkoj në shkollë.*

*Orët mësimore më fillojnë në ora tetë.*

*Të premtën jam/shkoj në seksionin e Shkencave të Natyrës.*

*Unë shkoj në stërvitje të hënën, të mërkurën dhe të premtën.*

- **Kontributi im në shkollë**

*Oborri i shkollës – një vend i pastër, i bukur dhe i sigurt për të qëndruar.*

*Në cilat fusha të jetës shkollore mund të marr pjesë dhe të kontribuoj?*

*Mund të kontribuoj në zbukurimin e klasës.*

*Mund të lëshoj muzikë në altoparlant.*

*Mund të bëj një sondazh për jetën kulturore dhe argëtuese.*

*Shkolla ime është e imja sepse kam mundësinë të propozoj këto aktivitete/iniciativa...*

## b) Njësitë leksikore

- **Emrat:** *admirim, kreativitet, origjinalitet, interes, dëshirë, liri, veprimtari, shkathtësi, bashkëpunim, shoqërim, besim, vetëbesim...*  
Aktivitete të lira të nxënësve: *basketboll, futboll, shah, muzikë, seksion, stacion i transmetimit...*  
Ndërtimi i një imazhi për veten si anëtar i familjes dhe si nxënës: *respekt, besim, dashuri, ndryshim, pubertet, krahasim, shok, nevojë, mbështetje, komunikim, rrethanë, shprehi, situatë, pakënaqësi*  
...
- **Mbiemrat:** *i qetë, i aftë, i vendosur, i sigurt, i respektuar, interesant, i kënaqur, krijues, origjinal...*
- **Foljet:** *respekton, nuk respekton, frikësohet, vendos, fyen, kërkon, jep, komenton, zgjidh, sillet, di, interesohet, beson, shprehet, vepron...*
- **Ndajfoljet:** *këtu, atje, këndeje, andej, qetë, qetësisht, kënaqshëm, trimërisht, mjaft, pak, shumë, dyfish...*
- **Lidhëzat dhe parafjalët:** *(dhe, edhe, ose, kurse, prandaj, sepse, por; në, nën, mbi, nga, për, përmbi, mes... )*
- **Fjalët dhe shprehjet pyetëse:** *a, çfarë, kush, ku, kur, sa, pse, si, në çfarë mënyre...*

- Përdor emrat e mësuar që tregojnë interesat, mundësitë, veprimet dhe tiparet të tij/saj dhe tipare karakteri në situata të reja shkollore dhe familjare.
- Lidh saktë afinitetet e veta me aktivitetet që rrjedhin nga përmbajtjet programore në shkollën e tij/saj.
- Emërton dhe numëron aktivitetet e lira të nxënësve që realizohen në shkollën e tij/saj.
- Tregon ngjarjet më të rëndësishme në familje dhe në shkollë, duke përdorur emra të përveçëm dhe mbiemra cilësorë.
- Lidh saktë karakteristikat e personalitetit të nxënësit në shtëpi dhe në shkollë, duke përdorur emra të përgjithshëm, të përveçëm, emra abstraktë dhe mbiemra cilësorë.
- Përdor trajtat e përemrave dëftorë dhe vetvetorë në shprehje të shkurtra me emra të mësuar.
- Ndërton fjali/ shprehje të shkurtra duke përdorur folje në të pakryerën dhe të kryerën e thjeshtë në kontekstin përkatës.
- Ndërton fjali të shkurtra me lidhëza dhe parafjalë (*dhe, edhe, ose, kurse, por; në, nën, mbi, nga për, përmbi, mes... )*

### c) Strukturat gramatikore

#### Fonetika dhe drejtshqiptimi

- **Shqiptimi i drejtë i bashkëtingëlloreve:** *dh, l, ll, rr* dhe *th* të sistemit të tingujve të gjuhës shqipe.
- **Ndërrimet fonetike:** dukuria e shurdhimit të tingujve të zëshëm në fund të fjalës
- **Theksi në gjuhën standarde shqipe** (parafundor, fundor dhe tejfundor)

#### Morfologjia

##### • Emrat

Llojet e emrave: konkretë (*trëndafili, guri, uji, akulli, tavolina, dera, mobilje*) dhe emra abstraktë (*dashuria, pikëllimi, heshtja, dhimbja, aspirata*)

*E këputa trëndafilin e kopshtit tonë. Bleva një fletore në librari. Babai im ndjen dhimbje të forta në gju.*

*Unë dhe nëna ime patëm një grindje të vogël dje.*

Kategoritë gramatikore të emrit - kategoria e gjinisë, e numrit, e shquarsisë dhe e rasës:

*Qeni po leh. Qentë e lagjes lehin njëkohësisht.*

*Lehja e qenit më shqetëson. Ai e ledhaton qenin. I jap ujë qenit.*

Formimi i shumësit tek emrat: nuk ndryshojnë temën (*nxënës, mësues, qen, muaj, mace, mike, shoqe*), me prapashtesa (*dyqane, arsimtarë, emra, vajza, lodra, gjëra*), me ndërrime tingujsh (*mik-miq, zog-zogj, lepur-lepuj, shekull-shekuj, dorë-duar derë dyer, natë-net*),

- Shqipton drejt tingujt e gjuhës shqipe me kujdes të posaçëm për shqiptimin e bashkëtingëlloreve *dh, l, ll, rr* dhe *th*.
- Njih dukurinë e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës.
- Riprodhon me theks të saktë fjalë që ka mësuar kur lexon dhe kur bisedon.
- Dallon shembuj emrash konkretë dhe abstraktë.
- Ndërton fjali duke përdorur emra konkretë dhe abstraktë.
- Dallon emrat sipas kategorisë gramatikore të gjinisë, të numrit, të shquarsisë dhe të rasës.
- Zbaton drejt emrat sipas kategorisë gramatikore të gjinisë, të numrit, të shquarsisë dhe të rasës në komunikimin me gojë dhe me shkrim.
- Njih dhe dallon shprehje ku emrat janë në trajtën e shquar (të shquar).
- Dallon mënyrën e formimit të shumësit me prapashtesa dhe me ndërrimi tingujsh.
- Njih llojet e mbiemrave sipas kuptimit dhe sipas veçorive morfologjike.
- Njih dhe dallon sipas vetës, gjinisë dhe numrit përemrat vetorë, trajtat e përemrave vetorë dhe përemrat dëftorë në komunikimin me gojë dhe me shkrim.
- Identifikon dhe përdor trajtat e përemërit vetvetor në situata të ndryshme të të folurit.
- Dallon foljet sipas kategorive gramatikore të mënyrës, të vetës, të numrit dhe të kohës dhe i përdor drejt.
- Dallon kohën e pakryer dhe kohën e kryer të thjeshtë të foljes dhe i përdor ato drejt.
- Shënon foljet në kohën e tashme në mënyrën dëftore, lidhore dhe dëshirore.
- Njih trajtat e foljeve që shprehin kohën e ardhme.
- Njih dhe dallon format e mënyrës dëftore, lidhore dhe dëshirore në kohën e tashme.

- **Mbiemrat**

Klasifikimi i mbiemrave – sipas kuptimit leksikor (cilësorë dhe marrëdhëniorë) dhe sipas veçorive morfologjike (të nyjshëm dhe të panyjshëm)  
*Fikreti dhe Filipi zbukurojnë oborrin e shkollës së re.*  
*Fustani i mëndafshhtë i rrinte shumë bukur Anës.*  
*Viti i parë kaloi shumë shpejt.*  
*Lapsi i kuq kishte humbur në dhomën Erminit.*  
*Fshehtësia i tregohet shokut besnik.*

Kategoria gramatikore e gjinisë, e numrit dhe e rasës të mbiemrat

*Shtëpia e madhe dhe oborri i madh binin në sy nga larg.*

*Malet e larta ishin mbuluar me borë.*

*Aleksandri dëgjon me vëmendje shokun e ngushtë.*

*Ai të gjitha do t'ia tregojë edhe shoqes së re.*

*Shokut të dikurshëm do t'ia thotë më vonë.*

- **Përemrat**

Përemrat vetorë; Përemrat dëftorë (ai, ajo, ata, ato; ky, kjo, këta, këto)

Përemri vetvetor **vetë**

*E pashë veten në vitrinë.*

*I thashë vetes të mësoj.*

- **Foljet**

Përdorimi në mënyrën, vetën, numrin dhe kohën e duhur

Koha e tashme – mënyra dëftore, lidhore dhe dëshirore

*Unë shkoj në Dibër çdo javë. Atje duhet të shkoni për të bërë nder. Shkofsh shëndoshë e mirë!*

- Njeh dhe krahason format e kohës së tashme me ato të së pakryerës dhe të së kryerës së thjeshtë në mënyrën dëftore.
- Dallon lidhëzat dhe parafjalët në raport me pjesët e tjera të ligjëratës gjatë përdorimit të tyre në fjali.
- Përdor drejt në fjali togfjalëshat e ndërtuar nga një emër dhe një mbiemër.
- Ndërton fjali dhe identifikon renditjen e drejtë dhe jo të drejtë të fjalëve në një fjali të thjeshtë.

Koha e pakryer

*Dina **shkonte** shpesh atje. Duhej **të shkonte** për shumë arsye.*

Koha e kryer e thjeshtë

***Shkova** për një urim. Duhej **të kem shkuar** që më parë.*

Koha e ardhme

*Agimi **do të na vijë** nesër.*

*Nikolla **do të hajë** pa ne.*

*Gjulaji **do të punojë** në kompjuter.*

- **Lidhëzat dhe parafjalët**

Kuptimi dhe përdorimi i lidhëzave për të lidhur gjymtyrët e fjalisë dhe pjesët e fjalisë së përbërë jo aq komplekse

*(Unë **dhe** Nafia jetojmë në të njëjtën rrugë.; Babai i Petritit u kthi **nga** rruga.; Ti do të këndosh, **ndërsa** ajo do të luajë në instrument.; Nëna ime di turqisht, **por** ajo nuk di shqip; Vëllai im jep provimin **për** shofer sot.; Bie shi edhe **mbi** liqen.)*

**Sintaksa**

- **Fjala e thjeshtë.** Përdorimi i togfjalëshave të ndërtuar nga një emër dhe një mbiemër (grupi emëror): *shtëpi e bardhë; një histori magjike; qilim shumëngjyrësh; karamelë të ëmbla*

**ç) Të lexuarit dhe të shkruarit**

- Dëgjimi dhe leximi i teksteve të shkurtra me leksik të përshtatshëm, dialogë dhe fjali me strukturë gramatikore më komplekse

- Lexon me shqiptim të saktë të tingujve, theksim të saktë të fjalës dhe intonacion të saktë të fjalisë.
- Dëgjon dhe lexon fjalë të reja, dialogë dhe tekste të shkurtra.
- Dëgjon, lexon dhe u përgjigjet pyetjeve të synuara që lidhen me dialogë dhe tekste të shkurtra.

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëgjon dhe lexon fjalë të reja, dialogë dhe tekste të shkurtra.</li> <li>• Dëgjon, lexon dhe u përgjigjet pyetjeve të shkurtra që lidhen me dialogë dhe tekste të shkurtra.</li> <li>• Të shkruarit (në mënyrë të pavarur ose me diktim)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkruan një dialog të shkurtër.</li> <li>• Shkruan një tekst të lidhur (5-6 fjali) me rendin e drejtë të gjymtyrëve të fjalisë.</li> <li>• Përdor drejt shkronjën e madhe kur shkruan emrat, mbiemrat dhe pseudonimet (nofkat), emrat e institucioneve, emrat e botës mitologjike e fetare, emërtimet gjeografike (edhe të një emri vendi prej dy a më shumë fjalësh), emërtimeve të festave kombëtare e ndërkombëtare etj.</li> <li>• Përdor saktë pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen, presjen, dy pikat, shumëpikëshin, kur shkruan me diktim ose në mënyrë të pavarur.</li> </ul>
<p><b>d) Tema për diskutim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Respekti për të gjithë në shkollë, edhe ndaj atyre që ndryshojnë nga ne</li> <li>• Ndërkombëtarizmat dhe ballkanizmat - fjalë që shqiptohen njësoj ose në mënyrë të ngjashme në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e komuniteteve që e mësojnë shqipen si gjuhë jo amtare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon karakteristikat lidhur me funksionimin e shkollës së vet (vlerat, tradita, klima në shkollë, mundësitë, toleranca ndaj dallimeve, bashkëpunimi, komunikimi etj.) në raport me shkollat e tjera.</li> <li>• Tregon përfitimet e të jetuarit, të mësuarit dhe shoqërimit me komunitete të ndryshme etnike në shkollën e vet ose me nxënës të tjerë nga një shkollë tjetër.</li> <li>• Dëgjon, kupton dhe u përgjigjet pyetjeve/informatave që kanë të bëjnë me ngjashmëritë dhe dallimet e nxënësve në sjellje, në të mësuar dhe në shoqërim.</li> <li>• Prezanton fjalë që janë të ngjashme ose të ndryshme në aspektin e shqiptimit në gjuhët ballkanike.</li> </ul>
<p><b>Shembuj të aktiviteteve:</b></p> <p><i>(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit ndahen në grupe me nga tri veta. Çdo nxënësi i jepet një fletë prej letre. Mësimdhënësi/ja jep udhëzimin: “Secili duhet të mendojë dhe të kujtojë diçka që ka bërë ose ka arritur dhe që e dallon nga bashkëmoshatarët e vet – diçka që e bën atë të veçantë në krahasim me të tjerët ( p.sh. <i>di të lexoj shkronjat me kokë poshtë; unë di të zgjidh kubin e Rubiku; fitova ping pong në konkursin e qytetit</i>)”. Brenda treshes, nxënësit shkëmbejnë “veçantitë” e tyre dhe bien dakord se kush kë do të përfaqësojë përballë të tjerëve, duke u shprehur me një fjali unike. Ata shkruajnë veçantinë e personit që duhet të përfaqësojnë në një fletë prej letre dhe e lexojnë atë para të gjithë nxënësve të klasës. Nxënësit e tjerë marrin me mend se kujt i referohet veçantia.</li> </ul>	



- Nxënësit sjellin material përmes të cilit prezantojnë dikë që e adhurojnë, që është idhulli i tyre etj. Duke e paraqitur personin para të tjerëve, ata përdorin mbiemra që japin tiparet e karakterit dhe arritjet e personit në fjalë.
- Nxënësit, në çifte, krijojnë pyetje intervistash për t'u bërë të rriturve. Ata shkruajnë tri deri në katër pyetje. Për shembull: si quheni? Sa vjec jeni? Çfarë bëni? Si u futët në të? Çfarë shkollë apo trajnimi keni përfunduar? Çfarë ju ka ndihmuar në shkollë apo trajnim? Orën tjetër, çdo nxënës duhet të intervistojë dy të rritur dhe të shkruajë përgjigjet. Nga përgjigjet me ndihmën e mësuesit njohin fjalët: admirim, krijimtari, origjinalitet, interes, dëshirë, liri, veprimtari, aftësi, bashkëpunim, miqësi, besim, vetëbesim etj. dhe diskutojnë kuptimin e tyre.
- Nxënësit ndahen në grupe me nga katër veta, dhe secilit nxënësi i jepet një kopje e fletës së punës në të cilën duhet të vendosin aktivitetet e preferuara që ka bërë me ndonjë anëtarë të familjes tre vjet më parë dhe ndonjë aktivitet që kryen tani. (p.sh. *dikur doja të luaja shah, tani dua të eci buzë lumit*). Ata duhet të zgjedhin tre anëtarë të familjes që mund të jenë të afërm ose të largët. Puna paraqitet para gjithë klasës.
- Nxënësit shkruajnë në mënyrë të pavarur orarin e mësimit dhe e prezantojnë atë përpara të gjithëve në klasë.
- Nxënësit, secili veç e veç para klasës, paraqesin lëndën e tyre të preferuar dhe tregojnë tri arsye pse pikërisht ajo është lënda e preferuar e tyre.
- Nxënësit lexojnë një listë të detyrave të shkollës, zgjedhin një që u pëlqen dhe një që e kryejnë sepse është e detyrueshme.
- Secili nxënës bën një prezantim para klasës për përgjegjësitë ditore.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grupi i jepet një detyrë e ndryshme: Grup i parë – *Çfarë mund të kontribuojë secili prej jush individualisht në zbulimin e klasës?* Grupi i dytë – *Çfarë mund të bëjë secili prej jush për shfaqjet dhe garat për t'i bërë ato më tërheqëse?* Grupi i tretë – *Çfarë mund të bëjë secili prej jush për ta bërë oborrin e shkollës një vend të pastër dhe të sigurt për qëndrimin e nxënësve?* Secili grup duhet të mendojë dhe të shkruajë ose të vizatojë në një fletë të madhe letre disa gjëra që secili prej tyre mund të bëjë për ta bërë shkollën një vend më të këndshëm për të qëndruar dhe mësuar. Më pas një nxënës nga secili grup prezanton detyrën.
- Nxënësit punojnë në çifte. Secili nxënës në çift thotë: *Unë mundem... Unë dua...* Fjalitë i referohen kontributit që nxënësit mund të bëjnë për shkollën.
- Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë fjalën “unike”. Secili individualisht mendon se çfarë i bën ata unik në krahasim me të tjerët në klasë. Mund të bëhet fjalë për pamjen, diçka që lidhet me familjen (të jesh binjak, të kesh 4 vëllezër etj.), hobi, lojërat e preferuara etj. Nxënësit identifikojnë tri gjëra që i bëjnë ata unikë.

- Nxënësit punojnë në çifte. Ata paramendojnë situata në të cilat duhet treguar respekt. Së bashku, ata përshkruajnë situatën në një copë të vogël letre. Fletat i vënë në tavolinë ose në mur. Kur të gjithë kanë mbaruar, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe lexojnë situata të ndryshme. Më pas nxënësit ulen në një rreth dhe mësuesi u flet atyre për situata ku duhej treguar respekt. Kërkon nga nxënësit të mendojnë se si mund të formulohen thëniet/fjalitë/mesazhet për të treguar respekt. Nxënësit paraqesin atë që kanë përgatitur.
- Nxënëve u jepet një listë me emra dhe me mbiemra që përshkruajnë interesat, aftësitë dhe tiparet e tyre. Nxënësit zgjedhin ato që mendojnë se u përshtaten dhe hartojnë fjali që i ndajnë para të gjithëve në klasë.
- Nxënësit ndjekin udhëzimet për t'u ndarë në grupe sipas prirjes së tyre ndaj: sportit, gjuhëve, shkencave natyrore, artit etj. Në secilin grup, të gjithë shkruajnë një fjali që më pas e ndajnë me zë të lartë, në të cilën thonë atë që duan të bëjnë më shumë nga ajo që mësojnë në shkollë dhe kjo është në interesin e tyre të ngushtë.
- Nxënësit ndahen në grupe, emërtojnë dhe numërojnë aktivitetet e lira të nxënësve që ofrohen në shkollën e tyre.
- Nxënësit marrin pjesë në një diskutim në të cilin rendisin ngjarjet më të rëndësishme në familje dhe në shkollë, duke përdorur emrat e duhur dhe mbiemrat përshkrues.
- Nxënësit i plotësojnë vendet e zbrazëta në një fletë me shembuj duke përdorur përemrat dëftorë.
- Nxënësve u jepet një listë me dy kolona foljesh: folje në kohën e pakryer dhe në kohën e kryer të thjeshtë. Ata vendosin çdo folje në një fjali të veçantë duke e përdorur atë pikërisht sipas kontekstit.
- Nxënësit krijojnë fjali të shkurtra me lidhëza dhe parafjalë (*dhe, ose, a, por; në, në, nën, mbi, për të*).
- Nxënësve u jepet një listë me fjalë që e përmbajnë tingujt: *dh, l, ll, rr* dhe *th* në pozicione të ndryshme. Ata nxiten të shqiptojnë saktë secilën fjalë. Më pas shkruajnë vetë disa fjalë të tilla, në mënyrë të pavarur.
- Nxënësit shikojnë material audio-vizual ku tregohet artikulimi i një tinglli/tingujve të veçantë, domethënë shqiptimi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve. Ata dallojnë dhe ndajnë tingujt zanorë nga tingujt bashkëtingëllorë. Pastaj shkruajnë disa fjalë me udhëzimet e mësimdhënësit dhe i ndajnë ato në rrokje. Në fund përfundojnë, se rrokja përbëhet nga një bashkëtingëllore dhe një zanore.
- Nxënësit ndjekin një prezantim me fjali të shkurtra në të cilat përdoren fjalët që përfundojnë me një bashkëtingëllore të zëshme. (*Dje shetitëm në malin Korab., Unë i vendosa paratë në xhep.*) Nxënësve u jepet detyrë të gjejnë fjalë që përfundojnë në një bashkëtingëllore të zëshme dhe pastaj i shqiptojnë ato. Shpjegohet se çdo bashkëtingëllore e zëshme në fund të një fjale shqiptohet ashtu si edhe bashkëtingëllorja e pa zëshme (*b-p; d-t; g-k; v-f; z-s* etj.). Në tabelë shkruhen çiftet e bashkëtingëlloreve të zëshme dhe të pa zëshme, dhe

ndërkohë, nxënësve u jepet një fletë pune me një varg fjalësh, shembull: *korb-korp; kënd-kënt; zog-zok; hov-hof; oriz-oris* etj. Nxënësit, me ndihmën e mësimdhënësit/es duhet të rrethojnë fjalën e shkruar saktë dhe më pas shqiptojnë fjalët nga vargu.

- Nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër dhe i njejti pastaj u jepet në fletë që ta lexojnë me zë të lartë, duke i kushtuar vëmendje theksit të fjalëve.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst të shkurtër me theks të saktë të fjalës dhe intonacion të përshtatshëm të fjalisë. Secili nxënës shkruan një fjali që e ka dëgjuar dhe e lexon me zë para të gjithë klasës duke u kushtuar vëmendje intonacionit dhe theksimit të fjalëve.
- Nxënësve u jepen karta me emra (që tregojnë qenie, sende, dukuri dhe koncepte), konkretë dhe abstraktë, i rendisin dhe japin nga një shembull duke formuluar fjali të shkurtër me secilin prej tyre.
- Nxënësve u jepet një fletë pune dhe u kërkohet që të plotësojnë vendet bosh në tabelë T, në të cilën jepen emra njëjës dhe shumës. Nxënësit duhet të plotësojnë vendet bosh. Shembull: *laps - \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_ - nxënësit ...* etj.
- Në vijim nxënësit lexojnë dialogë të shkurtër dhe të njejtit duhet t'i plotësojnë me përgjigje që paraqesin shembuj të shumës. P.sh.: *Sa orë keni mbajtur sot? Sot kishim vetëm dy orë. Sa ditë keni udhëtuar për në Zvicër? Udhëtua dy ditë.*
- Nxënësit luajnë lojë të llojit "gjeje gabimin" dhe pastaj e korrigjojnë atë: *qen besnike, kotele dembel, kalë të bukur, bletë punëtor.*
- Nxënësit ndahen në grupe, secili grupi i jepet një listë me emra. Ata duhet t'i thonë ata duke i ndryshuar sipas: gjinisë, numrit dhe trajtës. Më pas hartojnë fjali të shkurtra dhe i shkruajnë në tabelë dhe i kontrollojnë a janë të sakta.
- Nxënësit simulojnë një bisedë duke përdorur në mënyrë të përshtatshme përemrat vetorë. Shembull: *A ke ti dhomën tënde të veçantë? E ndaj me vëllain tim. Ai ta jep gjithmonë biçikletën? Unë konkurroj për shkollën tonë në çiklizëm.*
- Nxënësve u jepen karta me ilustrime. Për çdo ilustrim ka nga një detyrë, duhet që të hartojnë fjali duke përdorur foljen e duhur në numrin, vetën dhe kohën e duhur.
- Nxënësit punojnë në grupe të vogla. Secilit grupi i jepet një fletë pune ku duhet t'i ndyshojë foljet nga një kohë në një kohë tjetër.
- Nxënësit dëgjojnë tekste të shkurtra. Vetë nxënësve duhet të dallojnë fjalitë se kur veprimi është i shprehur në kohën e tashme, në të shkuarën: në të pakryerën dhe në të kryerën e thjeshtë apo në të ardhmen.
- Nxënësit punojnë në çifte. Secilit çifti i jepet një ilustrim (nga jeta shkollore-aktivitetet jashtëmësimore) si nxitje dhe motivim për të përshkruar ngjarje me fjali të shkruara ose të thëna gojarisht, ku në focus janë mbiemrat dhe përdorimi i drejtë i tyre, në të gjitha kategoritë gramatikore, duke u përshtatur me emrin.

- Nxënësve u jepet një listë e shkurtër me emra. Për secilin emër shkruajnë mbiemra aq sa dine, duke i përshtatur ato në gjini dhe në numër.
- Nxënësit ushtrojnë përdorimin e lidhëzave. Shembull: *Unë e pyeta nënën time \_\_\_ babanë tim për mendimin e tyre. Mendova për të mirat \_\_\_ për të këqijat e vendimit. Ai nuk beson tek unë, \_\_\_ për këtë ka një arsye etj.*
- VNxënëve u jepen fjali që kanë radhitje të saktë dhe të pasaktë të fjalëve. Shënojnë me shenjën  $\surd$ , rendin e saktë të fjalëve dhe komentojnë duke i korigjuar të gabuarat.
- Nxënësit dëgjojnë një tekst, gjejnë fjalët e reja dhe pastaj i përsërisin ata.
- Nxënësit në çifte lexojnë një dialog, pastaj lexojnë edhe pyetjet që lidhen me informacionin në dialog dhe i përgjigjen njëri tjetrit para të gjithëve.
- Nxënësve u jepet një listë me fjalë të sapo mësuara dhe shkruajnë një dialog të shkurtër.
- Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër për një temë që kanë mësuar (*Shkolla është vetëm e imja sepse..., respekti, bindja, mosrespekti...*) duke përdorur drejtë rendin e fjalëve në fjali.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me fjali ku të gjitha fjalët janë të shkruara me shkronja të vogla. Nxënësit duhet të shkruajnë me shkronjë të madhe aty ku është e nevojshme, në përputhje me rregullat për përdorimit e shkronjave të mëdha për emrat e përveçëm (*Unë jam në mavrovë çdo javë me vëllain tim lulin. essin nesër vjen nga gjermania për ta festuar bashkë 8 marsin, festën e nënës. Ajo ka shumë miq nga gjermania.*)
- Nxënësit shkruajnë një diktimi. Më pas ndahen në dyshe dhe e kontrollojnë të njëjtin nëpërmjet shembullit të shkruar në tabelë për përdorimin e saktë të pikës, të pikëpyetjes dhe pikëçuditjes, të presjes, tri pikave...
- Nxënësit punojnë në grupe të vogla prej tri vetash. Secilit grupi i jepet një fletë pune "*Për çfarë jemi të njëjtë dhe për çfarë ndryshojmë*" dhe kanë detyrë që ta plotësojnë në këtë mënyrë: Secili zgjedh një rreth për vete dhe shënon emrin e tij. Të gjithë imagjinojnë një listë të gjërave që pëlqejnë apo nuk pëlqejnë të bëjnë (p.sh. *Unë pëlqej të luaj futboll, të luaj lojëra kompjuterike, të ha makarona, sarma, kadaif ... Unë nuk pëlqej të ha spinaq, të zgjohem herët, të shkruaj detyrat e shtëpisë ...*). Nëpërmjet një diskutimit me të tjerët në grup, çdo nxënës duhet të gjejë se cilat nga ato gjëra vlejnë vetëm për të (që pëlqen/nuk pëlqen t'i bëjë vetëm ai/ajo), dhe cilat gjëra pëlqen/nuk pëlqen t'i bëjë njëjtë me dy nga nxënësit e tjerë në grup (dy nxënës pëlqejnë/nuk pëlqejnë të bëjnë gjëra të njëjta) dhe cilat gjëra janë të përbashkëta për të tre nxënësit në grup.

- Të gjithë nxënësit qëndrojnë në rreth dhe duhet të tregojnë pse e respektojnë njëri-tjetrin. Një nxënës fillon, duke u kthyer nga nxënësi në të djathtë të tij dhe duke thënë: *“Respekt për (emrin e shokut/shoqen e klasës) sepse (tregon tiparin ose sjelljen e shokut/shoqes në fjalë). Nxënësi të cilit i drejtohet respekti falënderon dhe i kthehet nxënësit/es tjetër në të djathtë dhe vazhdon me të njëjtën fjali e kështu me radhë deri sa të arrijë te nxënësi që ka filluar i pari.*
- Të gjithë nxënësit radhiten në rresht sipas një karakteristike të rënë dakord paraprakisht, për shembull sipas muajit të lindjes. Në të njëjtën kohë, ata nuk lejohen të flasin, por duhet të gjejnë një mënyrë tjetër për të komunikuar në mënyrë që të radhiten siç duhet.
- Nxënësit punojnë të pavarur. Të gjithë duhet t'u përgjigjen tri pyetjeve sipas radhës që janë shkruar: 1) *Tri gjëra të veçanta që vlejnë vetëm për mua.* 2) *Tri gjëra që i kam të përbashkëta me shokun/shoqen pranë të cilit/cilës jam ulur.* 3) *E kishe më të vështirë të gjeje gjëra që të bëjnë të ndryshëm nga të tjerët apo gjëra me të cilat ishe i ngjashëm? Pse?*
- Nxënësit diskutojnë për temën: *A është më e lehtë të gjesh dallime/ngjashmëri me më pak ose më shumë individë? Pse? Kur ndihemi më rehat? Kur mendojmë se jemi të ndryshëm nga të tjerët apo kur jemi të ngjashëm me të tjerët? Pse?*
- Nxënësit diskutojnë: Si tregohet respekti? Ata vinë në përfundim: Respekti shprehet ndryshe: me fjalë, me gjeste, me qëndrim të trupit. Kur e trajtojmë dikë me respekt, i lëmë hapësirë edhe të tjerëve të na trajtojnë me respekt.
- Nxënësit kanë për detyrë që brenda 15 ditëve të bëjnë kërkime dhe të bëjnë një listë me sa më shumë fjalë të jetë e mundur që kanë kuptim dhe shqiptim të ngjashëm në gjuhët që fliten në Ballkan. Prezantimet e suksesshme ndahen në një vend të përshtatshëm në klasë.

Tema: **Në rrethinën e afërt**

**Gjithsej: 26 orë**

**Rezultatet e të nxënit:**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të zhvillojë një bisedë në situata të ndryshme që përfshijnë një vizitë në treg, në restorant, në mjek, në barnatore.
2. të bëjë pyetje dhe t'u përgjigjet pyetjeve me njësi leksikore karakteristike për temat që diskutohen.
3. të hartojë fjali duke përdorur fjalët e njohura në kontekst të përshtatshëm dhe në formë gramatikore të përshtatshme.
4. të lexojë dhe të kuptojë dialogë, tekste të shkurtra dhe fragmente që flasin për komunikimet e përditshme.
5. të shkruajë tekst të shkurtër në të cilin do të përdorë në mënyrë përkatëse strukturat gramatikore: emrat, mbiemrat dhe përemrat në gjininë dhe numrin përkatës dhe foljet në kohën e duhur: koha e tashme, koha e kryer e thjeshtë, koha e kryer dhe koha e ardhme.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)	Standardet për vlerësim:
<p><b>a) Modelet e komunikimit</b></p> <p><b>Blerje</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li> <p><b>Në treg dhe në supermarket (shitore)</b>  <i>Në vendin tim ka një treg të madh/të vogël të gjelbër. Mund të blihet:...</i>  <i>Çmimet e produkteve dhe blerja - Sa kushton një domate? Sa kushton lakra?</i>  <i>Është më e shtrenjtë se ... është më e lirë se ...</i>  <i>Frutat dhe perimet e mia të preferuara janë:...</i>  <i>Nga frutat dhe perimet e mia të preferuara mund të bëj:...</i>  <i>Në shitore blej: mish, makarona, çokollatë, patatina...</i>  <i>Më pëlqen të gatuj/Nuk më pëlqen të gatuj</i>  <i>Shkëmbimi i recetës</i></p> </li> <li> <p><b>Në butik</b>  <i>A ka numër 14 prej kësaj? Po ka, por me ngjyrë tjetër. Kjo është e kuqe, kurse numri 14 është vetëm me ngjyrë të gjelbër.</i>  <i>A ka pantallona si në vitrinë? A keni këmisha? A keni xhaketa dimërore?</i>  <i>Kjo është pallto e trashë, a është prej leshi? Po, është prej leshi.</i>  <i>Bleva një bluzë pambuku ngjyrë kafe (rozë).</i>  <i>Dua të blej tuta sportive (trenerka).</i></p> </li> <li> <p><b>Në dyqan këpucësh</b>  <i>A keni numër 39 të këtyre këpucëve? Po kemi, urdhëroni.</i>  <i>A keni nga këto këpucë ngjyrë kafe?</i></p> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bën pyetje të thjeshta duke përdorur fjalë pyetëse të përshtatshme në kontekstin e blerjes së produkteve në treg dhe në dyqan (shitore).</li> <li>Përdor emrat në formën e duhur për situata që lidhen me blerjet.</li> <li>Përdor në mënyrë të duhur numrat dhe shumat e parave, duke i shprehur me numra.</li> <li>Formulon pyetje, me të cilat pyet për karakteristikat e gjërave që blen.</li> <li>Dallon kuptimin dhe përdor mbiemrat përshtatshëm në komunikim.</li> <li>Përdor folje të caktuara (<i>ka, blen, sjell, dëshiron</i>) në forma të përshtatshme për kohën e tashme, të kryer të thjeshtë, të kryer dhe të ardhme, gjatë komunikimit.</li> <li>Ndërton shprehje për situatat kur porosin në restorant dhe diskuton për menynë.</li> <li>Zhvillon dhe merr pjesë në një dialog të shkurtër rreth situatave në ordinancën e mjekut dhe në barnatore.</li> <li>Përdor shprehje të përshtatshme për të kërkuar ndihmë për kurim ose blerjen e ilaçeve.</li> <li>Përdor shprehje për kërkesa dhe falënderime në vende publike, kur bën pazar, kur viziton restorante dhe klinika.</li> <li>Numëron emrat e profesioneve të veprimtarive shërbyese që i has çdo ditë dhe shpjegon punën e tyre duke përdorur folje.</li> <li>Harton shprehje për vizitat e vendeve në natyrë, duke treguar karakteristikat e tyre.</li> <li>Përshtatshëm shkurt një vend në natyrë, një bimë ose një kafshë.</li> <li>Zhvillon dhe merr pjesë në biseda për natyrën, për bimët dhe për kafshët.</li> </ul>

*Dua të blej atlete të bardha/të kaltra/të kuqe. A keni numër 40? Më pëlqejnë të kaltra, nuk më pëlqejnë të bardha, por do t'i provoj.*  
*Trendet e modës - xhinse të ngushta, pantallona të gjera, xhup, bluzë, kanatiere, fanellë, jelek*  
*Në butikun dhe dyqanin e këpucëve ka: arkëtar/-e, shitës/-e, menaxher/-e*

### **Shërbime**

- **Vizitë në restorant**

*Menyja përfshin: fli, gishta pule, oriz në tepsi, gullash, doner, hamburger, patate të skuqura, supë, çorbë, sallatë prej...*

*Dua të porosis:*

*Sa kushton një pjatë? Një pjatë është...*

*Specialiteti i ditës është...*

*Më falni, kam vetëm lugë dhe thikë.*

*Me mungon piruni dhe gota.*

*Në restorant punojnë: kamerierë, kuzhinierë, pjatatarëse, pastrues.*

- **Te mjeku**

*Merti dhe Blerimi kanë virus në bark. U dhemb barku. Ata shkojnë te mjeku.*

*Gjyshja ka tension (shtypje) të lartë. Thirrni një ambulancë! Numri i urgjencës është 193.*

*Sevgi ka temperaturë, të shkojmë te mjeku amë.*

*Çfarë ju dhemb? Me dhemb krahu, këmba, fyti, zemra...*

*Unë jam ftohur, më rrjedhin hundët dhe kollitem.*

*Biljana ka grip. Ajo pi antibiotikë.*

*Ku ishe dje? Ishim te mjeku amë. Pse? Sepse ishim të sëmurë.*

<p><i>Në ordinancë ka: mjekë, laborantë, infermiere,....</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li> <p><b>Në barnatore</b>  <i>Më nevojitet ky ilaç. Çfarë ilaçi është ky? Ky është një ilaç për fyt të skuqur.  A keni recetë për ilaçin? Ky ilaç blihet me recetë. Është antibiotik.  Këto barna janë vitamina.  Farmacisti më shpjegoi se ky është ilaç i shtrenjtë.  Ne nuk e kemi këtë ilaç. A mund të kontrolloni se ku mund ta gjej? Po, por ky ilaç nuk gjendet në barnatoret tona.</i></p> </li> <li> <p><b>Natyra përreth nesh</b>  <i>Bota bimore dhe shtazore (flora dhe fauna):  përshkrime të kafshëve dhe të bimëve  Në fundjavë shkoj në ... Mavrovë, Ohër, Berovë, Dibër  Ka një liqen/pyll/park të bukur atje  Kafshët dhe bimët në Mavrovë  Mavrova është park nacional  Bimët dhe kafshët e Ponikvës dhe Pelisterit  Ku ishe në fundjavë?  Për fundjavën isha në vilën time në Rostushë.  Si kalove?  Ishte jashtëzakonisht bukur, mblodhëm çaj dhe thana.</i></p> </li> </ul>	
<p><b>b) Njësitë leksikore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li> <p><b>Emrat:</b> perime dhe fruta të vendit (mjedra, manaferra, thana, shega, dardha, molla, kajsia, pjeshka); perime: domate, spec, lakra, panxhar, karota, spinaq, borzilok, nenexhik, sherebelë, mish,</p> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Riprodhon dhe përdor emrat e sapomësuar duke dhënë shembuj.</li> <li>• Përdor emrat në gjininë dhe numrin e duhur.</li> <li>• Përdor në mënyrë të duhur emrat dhe mbiemrat kur kërkon, pyet ose kur përgjigjet, duke respektuar kategoritë e gjinisë, numrit dhe shquarsisë.</li> <li>• Përdor numrat deri në 1000 në komunikim të drejtpërdrejtë.</li> <li>• Dallon kuptimin e foljeve dhe i përdor ato kur jep shembuj.</li> </ul>



<p>makarona, çokollatë; butik, këmisha, bluza, këpucë, atlete, numri, madhësia; recetë, tension (shtypje), gjak, dhimbje, barnatore, mjek, ilaç, virus, antibiotik, vitamina; enë: pirun, thikë, lugë, pjatë, pjatë supe, pjatë të cekët, tenxhere, tigan... profesionet e restorantit, emrat e pjatave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbiemrat:</b> i/e madh, i/e vogël, i lartë, i ulët, i kripur, i butë, i thartë, i/e gjelbër, i kuq, i shijshëm, i drejtë, i gabuar, i bukur, i mrekullueshëm, i leshtë, i mëndafshtë, i pambuktë.</li> <li>• <b>Numrat:</b> deri 1000</li> <li>• <b>Foljet:</b> ha, pi, sjell, porosit, shërben, gatuan, lan, merr, jep, shpjegon.</li> <li>• <b>Fraza:</b> <i>Tregu është i lirë/i shtrenjtë; Kamariet, një meny ju lutem; Më falni sa kushton kjo? Dua të porosis.. A e keni ilaçin... Sa kushton...?</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor fraza dhe fjalë të reja që ka mësuar në komunikimin e përditshëm.</li> </ul>
<p><b>c) Strukturat gramatikore</b></p> <p><b>Fonetika dhe drejtshqiptimi</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqiptimi i drejtë i tingujve: <i>y, th, dh, gj, q, ë</i>, dhe i zanores <i>ë</i> të patheksuar</li> <li>• Ndryshimi i tingujve: dukuria e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme</li> <li>• Theksi në gjuhën shqipe (parafundor, fundor dhe tejfundor)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shqipton drejtë gjatë të folurit dhe të lexuarit tingujt: <i>y, th, dh, gj, q, ë</i>, dhe zanoren <i>ë</i> të patheksuar.</li> <li>• Njeh dukurinë e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme (p.sh: shkruajmë <i>ekzistencë</i> -lexojmë <i>egzistencë</i>).</li> <li>• Thekson me theks të saktë fjalët që shqipton.</li> <li>• Përdor format e sakta të emrave në kategoritë e gjinisë dhe numrit.</li> <li>• Përdor në mënyrë përkatëse mbaresat për të shprehur kategorinë e shquarsisë së emrave.</li> <li>• Përdor në mënyrë përkatëse nyjën e përparme kur mbiemrat qëndrojnë pas emrave në trajtën e shquar.</li> <li>• Krahason mbiemrat dhe përdor në mënyrë përkatëse format e tyre në shkallën pohore, krahasore dhe sipërore.</li> <li>• Njeh dhe shkruan numrat deri në 1000.</li> </ul>

## Morfologjia

- **Llojet e emrave:** konkrete (*atlete, pjatë, fustan, barnatore*) dhe abstrakte (*dashuri, lumturi, dhimbje, gëzim, frikë*)

*Ana bleu një fustan nga butiku i ri.*

*Ne përjetuam një lumturi të vërtetë në malin Galiçicë.*

*Elida dhe Ekremi e dërguan në spital gjyshin e lënduar.*

*Unë dhe nëna ime ishim në treg.*

*Ndjeva frikë kur më morën gjak nga gishti.*

- **Kategoria gramatikore e gjinisë, numrit, shquarsisë dhe rasës tek emrat:**

*Domatet janë shumë të shijshme në verë.*

*Specat dhe trangujt e kopshtit të gjyshit Sami janë më të shijshmet në botë.*

*Barnatorja është e furnizuar mirë me ilaçe.*

*Bëmë lëng nga thanat që mblodhëm.*

- **Mbiemrat** – mbiemrat marrëdhëniorë (*shall i leshtë, buzëqeshje fëmije, shtyllë e mermertë, qumësht lope, derë e hekurt, fustan i mëndafshtë*) dhe përshkrues - shkalla e mbiemrave  
*Ëmbëlsirat më të shijshme bëhen në kuzhinën e nënës*  
*Lëngu i kajsisë është më i tharët se i yni.*  
*Nuk kam takuar kurrë mësuese më të vyeshme se ajo.*

- Ndërton fjali duke përdorur mënyrën lidhore + foljen *dua / dëshiroj*.
- Përdor në mënyrë të duhur format për vetën dhe numrin e foljeve në kohën e tashme.
- Përdor kohën e tashme dhe mënyrën urdhërore dhe dëshirore në situata të ndryshme duke përdorur trajtat e përshtatshme të foljeve.
- Dallon foljet në kohën e tashme, në të kryerën e thjeshtë, në të kryerën dhe në të ardhmen.
- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve me: *Sa? Si? Çfarë?*
- Përdor lidhëzat e duhura për të lidhur pjesë të fjalisë dhe fjali të thjeshta.

- **Përshtatja e emrit dhe mbiemrit** në gjininë dhe numrin përkatës (*mot i bukur, grua e bukur, pantallona të bukura*)
- **Numrat deri në 1000**
- **Mënyra lidhore me foljen *dua*** (do/dëshiron të...)
 

*Unë **dua** të udhëtoj me tren.*  
*Ana **do/dëshiron** të **hajë** bakllava.*  
*Shpesh **duam** të **shkojmë** te kushërinjtë tanë.*
- **Frazat dhe kuptimi për foljen *kam*** (*kam-posedoj/zotëroj dhe ka-ekziston*)
 

***Kam** të gjitha llojet e materialeve për të qepur këmisha.*  
*Branko dhe Blerimi **kanë** një dyqan të madh në qendër të qytetit.*
- **Foljet**

Përdorimi në vetën, numrin, gjininë dhe kohën e duhur  
 Koha e tashme  
*Motra ime studion për mjekësi.*  
*Unë e mësoj gjuhën shqipe.*

Mënyra urdhërore dhe dëshirore  
 Koha e kryer e thjeshtë  
*Ajo e **lexoi** librin për tre orë.*  
*Jozefi dhe Meleku i **shkruan** detyrat.*

Koha e kryer  
*Ne **kemi qenë** në Strugë në festivalin “Këngë Jeho”.*  
*Ai **ka shëtitur** me shokun e tij të fëmijërisë.*  
*Disa herë **kam qenë** në Kërçovë.*

<p>Koha e ardhme <b>Do të mësoj</b> pasi të kthehem Luli dhe Leta <b>do të shkojnë</b> për pushime në Strugë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Fjalë pyetëse</b> – Sa? Si? Çfarë? Sa kilometra larg është fshati i gjyshit tuaj nga qyteti? Si kaluat në pushime? Çfarë djathi hani?</li> <li>• <b>Lidhëzat</b> Kuptimi dhe përdorimi i lidhëzave për të lidhur pjesë të fjalisë dhe fjali të thjeshta (Gëzimja shikonte televizor, <b>kurse</b> Driloni mëson.; Gjyshja <b>dhe</b> gjyshi bisedonin gjatë.; Do të shkojmë me pushime në Strugë <b>ose</b> në Ohër.; Halla ime di shqip, <b>por</b> nuk di anglisht; Ne i ftuam të vijnë te ne, <b>ndërsa</b> ata nuk erdhën.; Të shtunën bleva një libër <b>dhe</b> një enciklopedi në lirim.)</li> </ul>	
<p><b>ç) Të lexuarit dhe të shkruarit</b> (përmbajtje të lidhura me temën)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon tekste me fjalor të pasur nga situata komunikimi si tregu, mjeku, barnatorja.</li> <li>• Lexon tekste të shkurtra për kafshët dhe bimët.</li> <li>• Shkruan dialogë për situata të përditshme (treg, butik, restorant, mjek, barnatore)</li> <li>• Krijon përshkrime të bukurive natyrore, kafshëve dhe bimëve (5-6 fjali)</li> </ul>
<p><b>d) Tema për diskutim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Të njihemi</b> - Çfarë çaji pinë fqinjët në Maqedoninë e Veriut? (llojet e çajit, mënyra e përgatitjes, enët e servirjes, koha dhe vendi i çajit)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillon bisedë dhe merr pjesë në një diskutim rreth pirjes së çajit si karakteristikë e komuniteteve të ndryshme në vendin tonë.</li> <li>• Numëron dhe veçon kafshët dhe bimët e rralla që jetojnë në ambientet tona.</li> <li>• Shpjegon përmes shembujve mundësitë për mbrojtjen e kafshëve të rralla.</li> </ul>

- **Eko tema dhe mëdyshje** – Si të mbrohen kafshët dhe bimët e rralla në Maqedoninë e Veriut?

### **Shembuj të aktiviteteve:**

*(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)*

- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup ka për detyrë të krijojë një dialog sipas dëshirës, që ka të bëjë me blerje në dyqan ose në treg, dhe të njëjtën duhet ta lexojnë para klasës.
- Nxënësit punojnë në çifte. Secili në çift shkruan pyetje për një situatë blerjeje, më pas shkëmbejnë pyetjet me njëri tjetrin, dhe secili shkruan përgjigje për pyetjet e bëra. Në fund, secili çift prezanton dialogun.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale, i shkruajnë pemët dhe perimet që u pëlqejnë dhe më pas krijojnë një recetë për to të cilin e ndajnë para të gjithëve duke bërë shpjegimin e saj (mund të paraqitet edhe me anë të vizatimit, posterit etj.).
- Nxënësit punojnë në çifte dhe simulojnë se janë në ordinancën e mjekut ose në farmacisë, duke përdorur shprehjet e duhura.
- Nxënësit nëpërmjet të fotografive njohin profesionet e ndryshme i emërtojnë profesionet duke përdorur folje përkatëse që tregojnë se cili profesion çka punon *(Ky është mjek, mjekon pacientë. Ky është kuzhinier, gatuan në restorant).*
- Nxënësit shikojnë foto nga bukuritë natyrore të vendit tonë dhe i përshkruajnë ato me fjalë i kanë mësuar/përvetësuar.
- Nxënësit hulumtojnë për bimët dhe kafshët e rralla në vendin tonë dhe bëjnë një poster me disa karakteristika specifike si përshkrim. Çdo njëri nga nxënësit tregon dhe prezanton posterin vet, disa nga posterët mund të vendosen në klasë.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grupi jepet ilustrime ose fotografi dhe një fletë pune me kërkesa: për çdo foto të shkruajnë se çfarë është dhe ta përshkruajnë atë me aq mbiemra sa dinë, duke i kushtuar vëmendje gjinisë, numrit dhe shquarsisë. Më pas me fjalët e shënuara, secili grup duhet të formojnë fjali/shprehje dhe në fund prezantojnë punën e bërë.
- Nxënësit i lexojnë numrat të ndryshën nga kartat. Secilin numër e shënojnë dhe më pas e shkruajnë edhe me shkronja.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Ju jepet një tekst të mbushur me fjalë që i mësojnë nga tema, i lexojnë me zë duke përmisuar shqiptimin dhe theksin e fjalës.

- Me ndihmën e ilustrimeve nxënësit shkruajnë emra në gjininë dhe numrin e duhur dhe më pas i kthejnë në trajtën e shquar sipas udhëzimeve të dhëna në fletën e punës. Diskutojnë për ndryshimet e bëra në trajta dhe më pas secili/a shkruan nga një shembull të cilin e prezantojnë para klasës.
- Nxënësve ju jepen fotografi me ilustrime këpucësh, veshjesh, ushqimesh. Ata i përshkruajnë ato dhe i rrathisin sipas karakteristikave të tyre (madhësisë, gjatësisë, sasisë, shijes...). Shembujt në shkallën e duhur krahasore dhe sipërore i shkruajnë në një fletë të madhe dhe i ngjeshin në klasë.
- Nxënësit shkruajnë në një fletë disa dëshira të tyre me udhëzim të mësimdhënësit/es që ta përdorin mënyrën lidhore + foljen *dua*. Më pas çdo shembull shkruhet në tabelë. Nga shembujt nxënësit nxjerrin përfundim për përdorimin e drejtë të kësaj foljeje në kohën e tashme.
- Nxënësit numërojnë se çfarë kanë për momentin në dhomën e tyre, çfarë kanë pasur më parë dhe çfarë duan të ketë në të ardhmen. Më pas ata diskutojnë ndryshimin e foljes *kam* në kohë të ndryshme. (*Në dhomën time kam një tavolinë. Më parë kisha një radio. Pas dy muajsh do të kem një pikturë të madhe*).
- Nxënësit simulojnë situatë, shembull: një gjyshe e shtrirë, një fëmijë i sëmurë me grip. Mësimdhënësi/ja jep udhëzime se si të përdorin fjali urdhërore: *Më sill ujë! Më blej limon! Më ndihmoni të ngrihem! etj.*
- Nxënësit hartojnë një dialog me pyetje se ku kanë qenë dje/pardje ose javën e kaluar. Me udhëzime nga mësimdhënësi/ja, udhëzohen që në përgjigjet e tyre të përdorin kohën e shkuar, si në shembujt e dhënë: *isha, ishim, vizitova, eca, kalova...* Dialogun e lexojnë para të gjithëve në klasë.
- Nxënësit lexojnë një tekst të shkurtër lidhur me një shëtitje në natyrë dhe më pas u përgjigjen pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi/ja, rreth asaj që lexuan.
- Nxënësit bëjnë një përshkrim të shkurtër me 5-6 fjali - për diçka nga natyra, ndonjë bimë ose ndonjë kafshë dhe përshkrimin e bërë e lexojnë para të gjithëve. (*Ky është borziloku. Ai rritet nëpër kopshtet shtëpiake. Ka erë shumë të fortë. Përdoret si erëz, por përdoret edhe si ilaç/bar*).
- Nxënësit bëjnë prezantim të llojeve të ndryshme të çajit, duke e treguar mënyrën e përgatitjes, si shërbehet, si dhe kohën dhe vendin kur pihet çaji: në shtëpi, kur shkojnë mysafirë, pihet për kënaqësi, për shëndet...
- Nxënësit të ndarë në grupe punojnë eko-poster duke shkruar mesazhe ekologjike mbi të. Secili grup prezanton punën e tij.

Tema: **KOMUNIKIMET, LIDHJET DHE NJOHJA E DALLIMEVE**

**Gjithsej: 21 orë**

**Rezultatet e të nxënit:**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të ndërtojë fjali me fjalor adekuat ku do të shpjegojë shkurtimisht se për çfarë përdoret interneti dhe rrjetet sociale.
2. të krijojë mesazhe dhe postime në gjuhën shqipe, duke respektuar rregullat e sjelljes etike në hapësirën online.
3. të merr pjesë në biseda për organizimin e udhëtimeve dhe përshkrimin e vendeve të vizituara duke përdorur format e përshtatshme të emrave, mbiemrave dhe përemrave.
4. të tregojë dhe planifikojë aktivitete duke përdorur foljet në kohën e ardhme dhe në kohën e shkuar.
5. të numërojë dhe të shpjegojë informacione lidhur me bukuritë natyrore, atraksionet dhe vendet turistike.
6. të udhëheq dhe të merr pjesë në biseda për tema të ndryshme.

**Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)**

**a) Modelet e komunikimit**

- **Si komunikojmë me botën;**  
Për çfarë e përdorim internetin (rrjetet sociale, postën elektronike).  
*Tezja ime jeton në Suedi. Unë komunikoj me të në Facebook.*  
*Vëllai im studion në Amerikë, ne shpesh komunikojmë me video thirrje.*  
*Unë jetoj në Strugë, kurse kushërinjtë e mi jetojnë në Ohër. Është afër, por nuk shihemi shpesh. Ne i shkruajmë njëri-tjetrit në Viber.*  
*Interneti më duhet për të komunikuar me ata që nuk i kam afër, për të mësuar dhe për t'u argëtuar.*
- **Udhëtime dhe ekskursione**  
Biseda rreth udhëtimeve; destinacioneve, mjetet e transportit

**Standardet për vlerësim:**

- Ndërton shprehje për të cilat shpjegon se çfarë rrjete online përdor.
- Krijon shprehje (postime dhe komente të shkurtra) të cilat përdoren në komunikimin online.
- Shpjegon me fjalët e veta se për çfarë i shërben interneti dhe rrjetet sociale.
- Formulon pyetje dhe përgjigjet duke përdorur kohën e kryer dhe kohën e kryer të thjeshtë të foljes që kanë të bëjnë me udhëtimet dhe vizitat e realizuara.
- Zhvillon bisedë me persona zyrtarë duke u informuar për udhëtime konkrete.
- Përdor fjali të thjeshta duke e përdorur kohën e ardhme për planet dhe udhëtimet e planifikuara.
- Rikrijon informacionet e gjetura për udhëtimet konkrete.
- Bëni listën e udhëtimit duke përmendur gjërat e nevojshme për udhëtim.
- Prezenton persona të tjerë duke përdorur fraza me informacione bazë rreth tyre.

<p><i>Kush ka qenë në... Asnjë nga ne nuk ka qenë në... Secili prej nesh ka qenë në atë vend. Ke qenë në...? Po, kam qenë/Jo, nuk kam qenë Dua të shkoj në... Atje mund të shkoni me... Ai vend është i famshëm për... Atje ka... Unë do të udhëtoj me... Do të vizitohet një muze, teatër, kopsht zoologjik, park, ndeshje futbollit, koncert Në aeroport/në stacionin e autobusëve /në stacionin e trenave Më falni, kur është fluturimi për në... Kur niset treni për... Kur arrihet autobusi atje? Lista e udhëtimit: pasaporta, bileta, rezervime, valixhe, harta turistike Më pëlqen të udhëtoj / Nuk më pëlqen të udhëtoj – sepse...</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Njoh kultura të tjera</b> <i>Ky është .... Ai tani jeton këtu, por është lindur dhe arsimuar në Belgjikë. Këta janë miqtë e mi të rinj nga Turqia. Ata janë nga qyteti i ...</i></li> </ul>	
<p><b>b) Njësitë leksikore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● <b>Emrat:</b> <i>informacion, rrjet, shpallje, fotografi, postim stacion, aeroport, aeroplan, tren, autobus, hartë , biletë, pasaportë, qytet, liqen, mal, vend, muze, park, koncert, ndeshje futbollit</i></li> <li>● <b>Mbiemrat:</b> <i>turistik, turistike, sociale</i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përdor në mënyrë të saktë njësitë leksikore në fjalitë dëftore dhe pyetëse, duke respektuar rregullat gramatikore për përdorimin e emrave, mbiemrave dhe kategoritë e tyre gramatikore.</li> <li>● Përdor në mënyrë të duhur njësitë leksikore në fjalitë dëftore dhe fjalitë pyetëse, duke respektuar rregullat gramatikore për përdorimin e foljeve në kohën, vetën dhe numrin e duhur.</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Folje:</b> udhëton, niset, mbërrin, ngrihet, ateron, shkruan, dërgon, merr.</li> </ul>	
<p><b>c) Strukturat gramatikore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përemrat</b> Përemra pyetës:(<i>kush, cili, ç', çfarë, sa....</i>); Përemra lidhor: (<i>që, i cili, e cila</i>); Përemra të pacaktuar: (<i>dikush, askush, asnjëri, diçka, disa...</i>) <b>Cilët janë udhëtarët e rinj për në Stamboll?</b> <b>Cilin libër po e kërkoni?</b> <i>Ishte shumë i lumtur që po udhëtonte.</i> <b>Dikush ka postuar informacion në Facebook.</b> <b>Çdokush informohet për diçka nga Instagrami.</b></li> <li>• <b>Koha e ardhme</b> <i>Marko do të shkojë në Berovë.</i> <i>Ai do të udhëtojë me makinë. Do të qëndrojë në një hotel privat pranë liqenit. Aty do të shohë bukuritë e liqenit të Berovës dhe rrethinës së tij.</i> <i>Mustafai do të udhëtojë për në Resnjë. Ai do të vizitojë miqtë e tij në Resnjë. U dërgoi mesazh atyre se do të mbërrijë në orën 14:00. Ata do ta presin para xhamisë së qytetit.</i>  Koha e pakryer <i>Në fshatin tonë jetonin shumë prodhues të mjaltit.</i> <i>Ti doje të jetoje në qytet të madh.</i></li> <li>• <b>Ndajfolje:</b> atje, shpesh, rrallë, askund, kurrë, më herët, më vonë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor drejt përemrat pyetës, përemrat lidhor dhe përemrat të pacaktuar në komunikimin verbal dhe joverbal (me shkrim me gojë).</li> <li>• Bën pyetje dhe përgjigjet duke e përdorur kohën e ardhme për planet dhe vizitat e ardhshme.</li> <li>• Ndërton fjali duke përdorur foljet e njohura në kohën e ardhme.</li> <li>• Shpjegon duke e përdorur kohën e pakryer për veprime në të kaluarën.</li> <li>• Dallon dhe gjen kryefjalën dhe kallëzuesin në fjali.</li> <li>• Përdor në mënyrë të saktë kryefjalën dhe kallëzuesin, duke respektuar rendin e fjalëve në fjali.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Fjalia</b> Kryefjala dhe kallëzuesi në fjali <i>Ilinka punon. Artani lexon libër. Ilinka dhe Artani do të shkojnë së bashku në ekskursion.</i></li> </ul> <p>Renditja e fjalëve në fjali (kryefjala , kallëzuesi, përcaktuesi) <i>Nxënësit vizituan muzeun.</i> <i>Ne pimë çaj çdo ditë në orën 17:00.</i></p>	
<p><b>ç) Të lexuarit dhe të shkruarit</b> <i>(përmbajtje të lidhura me temën)</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lexon dhe kupton tekste të thjeshta nga shkrimtarë të njohur shqiptar.</li> <li>• Lexon dhe nxjerr informata të rëndësishme nga një tekst.</li> <li>• Rikrijon informacione në një tekst të dhënë – të lexuar ose të dëgjuar.</li> <li>• Lexon dhe shpjegon broshurat, hartat dhe oraret e qarkullimit/udhëtimit.</li> <li>• Shkruan mesazhe të shkurtra të cilat i shkëmben në komunikimin online në mediat sociale dhe platforma të tjera duke respektuar standardet etike.</li> <li>• Shkruan një tekst të shkurtër (5-6 fjali) duke përshkruar një vend që ka vizituar.</li> </ul>
<p><b>d) Temat për diskutim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dhjetë vendet më të njohura dhe më të bukura në Maqedoninë e Veriut;</li> </ul> <p>Vend më i bukur që kam vizituar jashtë Maqedonisë së Veriut <i>(Udhëtime në vend, udhëtime jashtë vendit, kam qenë në... Dua të udhëtoj në ....)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja (inkluzioni) ndjeshmëria (empatia)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjenë informacione nga materiale turistike e nga materiale të tjera dhe bën prezantimin e tyre.</li> <li>• Përshkruan vendet e vizituara duke dhënë informatat bazë dhe karakteristikat e tyre.</li> <li>• Njeh dallimet dhe i diskuton ato si karakteristika pozitive.</li> <li>• Udhëheq diskutime kundër diskriminimit dhe merr pjesë në to.</li> <li>• Krijon fraza dhe slogane kundër diskriminimit të çdo lloji.</li> </ul>

### Shembuj të aktiviteteve:

*(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)*

- Nxënësit punojnë të pavarur. Në fletë, vizatojnë logot ose shenjat mbrojtëse të platformave dhe rrjeteve online që përdorin. Secili nxënës tregon se për çka e përdor secilen nga rrjetet duke shfrytëzuar modele të përshtatshme për tu shprehur. *(Unë shpesh shkruaj në Mesenxher. Motra ime përdor Viber-in. Unë nuk kam Facebook, por kam Instagram.)*
- Nxënësit në mënyrë të pavarur shkruajnë postime të mundshme në një temë të caktuar. Të shkruarit e kontrollojnë së bashku në tabelë.
- Nxënësit punojnë të pavarur. Radhisin tre aktivitetet më të rëndësishme kur ata përdorin më shumë internetin. Për çdo aktivitet të veçantë, ata thonë nga një fjali.

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup jepet material pune ku janë paraqitur vende të ndryshme nga Maqedonia e Veriut. Ata shkruajnë një tekst të shkurtër për vendin që është paraqitur në material. Disa grupe përdorin kohën e pakryer, disa kohën e ardhme. Secili grup paraqet atë që ka shkruar, ashtu që secili nxënës nga grupi thotë nga një fjali.

- Nxënësit punojnë në çift. Diskutojnë se kush ku ka qenë. Simulimi përdoret për të ushtruar kohën e pakryer *(Ishe në Kavadar? Jo, nuk isha, po ti ishe në Tetovë?)*
- Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, vizatojnë një hartë të vogël ose një monument kryesor ose pikë referimi të një vendi. I përdorin frazat të cilat janë të shkruara në tabelë: *Dua të shkoj në... Atje arrihet me ... Ai vend është i njohur për... Atje ka... Do të udhëtoj me...* Çdo nxënës shprehet i pavarur.
- Nxënësit planifikojnë një vizitë në Ohër. I shkruajnë planet e tyre se cilat lokalitete do t'i vizitojnë, ndërkohë kujdesen që të përdorin kohën e ardhme.
- Nxënësit nsahen në grupe. Secilit grup i jepet udhëzimi për të simuluar një situatë, sikur do të shkojnë të vizitojnë një ndeshje futbolli midis dy ekipeve të mëdha në një qytet evropian. Duhet të organizojnë udhëtimin. Shkruajnë dialogje për të gjitha komunikimet zyrtare që duhet të kryejnë para se të nisen. Secili grup prezanton dialogët e përgatitur në një poster/hamer para gjithë klasës.
- Nxënësit simulojnë sikur duhet të vizitojnë Krushevën, kërkojnë informacione në broshura dhe harta të cilat paraprakisht i ka siguruar mësimdhënësi/ja dhe më pas riformulojnë informacione, shembull: *Krusheva është vendlindja e Toshe Proeskit; Krusheva është qyteti më i lartë ballkanik; Në Krushevë bëhen lokumet më të bukura* etj. Çdo informacion shkruhet në tabelë, gjegjësisht në fletore.

- Nxënësit ndahen në çifte dhe përgatisin një listë me gjërat e nevojshme për udhëtim. Radhisin gjërat dhe shkruajnë fjali për të njëjtët. Ndajnë para të gjithëve dhe plotësojnë njëri-tjetrin.
- Nxënësve u jepen fjali në të cilat mungojnë disa fjalë (të cilat janë të reja për fjalorin e tyre). Plotësojnë vendet boshe duke i kushtuar vëmendje gjinisë dhe numrit të emrave si dhe vetës, numrit dhe kohës së foljeve.
- Nxënësit krijojnë fjali të shkurtra që i referohen rrjeteve sociale ose ndonjë ngjarje aktuale që për moment është e rëndësishme për ta. Shkruajnë pyetje për të njëjtën duke përdorur përemrat përkatës.
- Nxënësit janë ulur në rreth dhe i bëjnë pyetje njëri-tjetrit. Në çdo pyetje do të duhet të përgjigjet ashtu që folja të jetë e shprehur në kohën e ardhme.
- Nxënësit punojnë në çifte. Krijojnë dialogje duke përdorur kohë të ndryshme foljesh: *Do të shkoj në Dibër. Unë nuk shkoj atje, sepse isha vitin e kaluar.*
- Nxënësve u jepet një fletë pune mësimore që përmban shembuj të ndryshëm: fjali me një kallëzues, fjali me dy kallëzues dhe një kryefjalë dhe anasjelltas. Fjalitë nuk kanë radhitjen e duhur të fjalëve dhe detyra e tyre është t'i vendosin fjalët në rendin e duhur të fjalive. Ajo që është punuar paraqitet para gjithë klasës.
- Nxënësit ndahen në grupe. U jepet fletë pune në të cilën janë shënuar "*mur me fjalë*". Krijojnë fjali në të cilat duhet të kenë kujdes që kryefjala dhe kallëzuesi të përshtaten sipas kategorisë së llojeve të fjalëve të përdorura.
- Nxënësit dëgjojnë një njoftim për vizitë në muze të organizuar nga shkolla. Informacionin e dëgjuar e riprodhojnë të gjithë bashkë, ndërkohë plotësojnë dhe pëmisojnë njëri tjetrin. (Aktiviteti mund të përsëritet me dy - tre informacione për një orë).
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet nga një hartë dhe orar të autobusëve të qytetit. Grupet përgatisin informata se si do të shkohet nga një vend/lagje në një tjetër. Ajo që është punuar nga secili grup paraqitet para gjithë klasës.
- Nxënësit në tabelën e mençur (ose në prezantim) shikojnë foto ose disa shpërndarje informatash në internetit mbi të cilat lënë komente. Secili e lexon komentin e vet.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Shkruajnë disa fjali për vendet që kanë vizituar nga ekskursioni i fundit njëditor dhe më pas e lexojnë para klasës.
- Nxënësit ndjekin disa video të shkurtra në të cilat shihen situata të ndryshme të diskriminimit. Nxiten të flasin për të, duke *përkufizuar* diskriminimin dhe shkruajnë fjali me të cilët shpjegojnë se si mund të kapërcehet situata që panë.

## GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet inkuadrimin të të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave /përmbajtjeve/ koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

## VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'u mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi/ja ndjek përvojat, njohuritë dhe aftësitë e mëparshme të nxënësve, përcjell vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informata kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe u japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim mësimdhënësi/ja përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet e dhëna me gojë pyetjeve të mësimdhënësit/es ose të nxënësve të tjerë;
- pyetjet e dhëna me gojë dhe pjesëmarrjen në diskutime gjatë orës mësimore;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;

- ushtrimet kontrolluese;
- testet e njohurive;
- punimet/realizimet praktike (të shkruarit/krijimin e teksteve sipas kërkesave të ndryshme, ekspozitat, ilustrimet, prezantimet etj.);

Pas përfundimit të secilës temë, nxënësi merr notë me numër për standardet e arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me notën e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

<b>Fillimi i zbatimit të programit mësimor</b>	Viti shkollor 2024/2025
<b>Institucioni/bartës i programit</b>	Byroja e Zhvillimit të Arsimit Биро за развој на образованието
<p><b>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe (gjuhë e bashkësive)</i> për klasën VII.</b></p> <p><b>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик (јазик на заедницата)</i> за VII одделение.</b></p>	<p>бр. 12-3742/2 01.04.2024 година</p> <p style="text-align: right;">Министер за образование и наука, Д-р. Jeton Shaqiri, с.р.</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: 0;"/>